

Bashkëpunimi parlamentar mes Kosovës dhe Serbisë

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar më 6 dhjetor, 2014 në Prishtinë, Kosovë, një tryezë të rrumbullakët për anëtarët e parlamentit të Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi i takimit ka qenë kontribuimi në normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, dhe mes shoqërive shqiptare dhe serbe. Shumica e folësve kanë përkrahur vazhdimin e dialogut, dhe poashtu kanë propozuar që dialogu dhe bashkëpunimi duhet të zgjerohen edhe në fusha tjera, me qëllim të arritjes së normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë qenë përfaqësues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dhe Partisë Progresive Serbe (SNS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Partisë Demokratike (DS), Partisë Social-Demokrate (SDS), dhe Lidhjes së Social Demokratëve të Vojvodinës (LSV). Tryeza e rrumbullakët është pjesë e projektit për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë, të përkrahur nga Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës.

Promovimi i bashkëpunimit bilateral

Bashkëpunimi mes parlamentarëve të Kosovës dhe Serbisë ndodhë përmes aktiviteteve të ndryshme rajonale dhe takimeve të organizatave ndërkombëtare, por deri më tani nuk është vendosur ndonjë formë e bashkëpunimit bilateral. Një numër takimesh të parlamentareve gra nga Serbia dhe Kosova kanë ndodhur. Të nxitura nga perspektiva e përbashkët e integriteteve evropiane, shtetet e Ballkanit në mënyrë graduale kanë rritur nivelin e bashkëpunimit politik e ekonomik mes tyre, duke përfshirë bashkëpunimin mes parlamenteve. Pjesëmarrësit kanë thënë se roli i parlamenteve në përmirësimin e marrëdhënieve mes qeverive dhe shoqërive nuk duhet nënvlerësuar. Ata kanë thënë se qeveritë në Prishtinë dhe Beograd kanë monopolin mbi komunikimin institucional, por kanë shtuar se roli i parlamenteve duhet fuqizuar. Disa madje kanë thënë se qeveritë kanë vendosur një kontroll pothuajse të plotë mbi parlamentet në aq shumë fusha, sa që parlamentarët duhet ta rifitojnë pavarësinë e tyre.

Përderisa është përgjegjësi e ekzekutivit që t'i negociojë marrëveshjet, parlamentarët kanë një rol të rëndësishëm në mbikqyrje, duke shtruar pyetje, si dhe në implementimin e marrëveshjeve përmes miratimit të ligjeve të nevojshme. Në këtë kontekst, bashkëpunimi mes parlamentarëve të Kosovës dhe Serbisë është me shumë vlerë, duke qenë se të dyja vendet pritet të miratojnë ligje të reja në mënyrë që të mundësohet implementimi i marrëveshjeve. Kjo jo vetëm që do të shënonte fillimin e një bashkëpunimi të ri

institucional, por gjithashtu do të plotësonte përpjekjet e qeverive në Prishtinë e Beograd në procesin e normalizimit të marrëdhënieve dhe konsolidimit të të arriturave të deritashme.

Pjesëmarrësit kanë thënë se dialogu dhe bashkëpunimi bilateral duhet të shëndrrohet në një gjë normale, sidomos tani që një lloj i marrëdhënieve është vendosur mes institucioneve të Kosovës e Serbisë. Disa pjesëmarrës kanë pranuar se ata nuk janë të kënaqur me dialogun e Brukselit, por kanë thënë se dialogu nuk ka alternativë dhe se marrëveshjet duhet të implementohen. Megjithatë, disa pjesëmarrës nga Kosova kanë theksuar se forma e dialogut është në disavantazh të Kosovës dhe se institucionet e saj nuk duhet të vazhdojnë të jenë pjesë e tij. Shumica kanë pritur që dialogu të vazhdojë në të njëjtin format si më parë, por kanë qenë skeptik se zyrtarët e Bashkimit Evropian nuk do të jenë po aq të angazhuar sa deri tani, duke pasë parasysh konfliktet e reja në Evropë e më tej. Në këtë kontekst, ata kanë thënë se bashkëpunimi bilateral është thelbësor në “lëvizjen më të shpejtë të gjërave”.

Përkundër disa rezervave, shumica e folësve kanë përkrahur dialogun por kanë rekomanduar që ai të jetë më transparent, posaçërisht në rritjen e komunikimit mes qeverive dhe shoqërive. Një folës është ankuar se qytetarët marrin vesh për detajet e marrëveshjeve vetëm atëherë kur marrëveshjet fillojnë të implementohen. “Dhe atëherë kur ata besojnë se këto marrëveshje nuk janë në dobi të tyre, atëherë ballafaqohemi me rezistencë”. Ai ka propozuar që popullata do të duhej të ishte më e përgatitur në lidhje me marrëveshjet. Roli i opinionit publik për të ushtruar tryzni mbi qeverinë që të jetë më transparente rreth dialogut të Brukselit është theksuar gjithashtu, por fatkeqësisht ky presion publik mungon pothuajse tërësisht.

Folësit kanë thënë se dialogu duhet poashtu t’i përfshijë mediat, biznesin, sportin dhe fushat tjera në mënyrë që t’i përmirësojë marrëdhëniet mes shoqërive në të gjitha fushat. “Tash marrëdhëniet mes kryeministrave të Kosovës e Serbisë janë më të mira sesa marrëdhëniet mes dy shoqërive, dhe do të duhej të ishte e kundërta, por kjo ndodhë për shkak të mungesës së komunikimit mes shoqërive” ka thënë një folës. Një tjetër folës ka thënë se tashmë ekziston një bashkëpunim i shtuar mes serbëve dhe shqiptarëve në këto fusha, dhe një numër i ngjarjeve kulturore të Kosovës janë organizuar në Serbi, dhe shumë artistë serbë kanë marrë pjesë në ngjarje në Kosovë.

Përveç dialogut të Brukselit, disa folës nga Kosova kanë thënë se duhet të ekzistojë një dialog i brendshëm mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Ky dialog është i rëndësishëm për përmirësimin e marrëdhënieve mes dy shoqërive. “Kjo është posaçërisht e rëndësishme për komunitetin serb, si një komunitet më i vogël”, ka theksuar një folës, duke shtuar se ekziston një përpjekje shumë më e madhe për përmirësimin e marrëdhënieve qeveritare, sesa për përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore.

Në lidhje me rolin e parlamenteve në këtë dialog, folësit janë ankuar se ata janë anashkaluar në procesin e dialogut. Kryeministri i Kosovës ka raportuar disa herë në parlament, por disa kanë thënë se në këto raportime, nuk janë dhënë informata te

detajuara. Në parlamentin serb, nuk ka pasur as raportim formal. “Nuk mund të përkrahë diçka për të cilën nuk kam informata”, ka thënë një folës.

Folësit kanë thënë se ata duhet të jenë më aktiv në ofrimin e këshillave dhe ideve, në mbikqyrjen dhe monitorimin e qeverisë dhe implementimin e marrëveshjes, dhe në kërkimin e më shumë informatave të detajuara mbi procesin e dialogut. Është përmendur idea që të dyja parlamentet të krijojnë komisione për të punuar në çështje të ndryshme të marrëveshjes. Një folës ka thënë se ata duhet ndërmarrë disa iniciativa të përbashkëta, pasi që “në kohëra të vështira është më lehtë të zgjidhen problemet së bashku”. Ky folës poashtu ka thënë se shoqëritë shpesh presin shumë nga politikanët, dhe kur pritjet e tyre nuk përmbushen, ata ndihen të zhgënjyer. “Kjo është një arsye më shumë se pse kemi nevojë të jemi në komunikim të vazhdueshëm me votuesit tanë, për t’ua shpjeguar sfidat e zgjidhjes së problemeve të tyre”. Një folës ka thënë se cilësia e demokracisë në të dyja parlamentet ka ende mungesa, dhe se deputetët duhet ti monitorojnë dhe kritikojnë edhe partitë e tyre. Politika ditore është përmendur si një faktor pengues në cilësinë e rolit mbikqyrës të parlamentit.

Disa nga fushat në të cilat parlamentet do të mund të promovonin bashkëpunimin janë arsimi, shëndetësia dhe personat e zhdukur. Arsimi dhe shëndetësia janë posaçërisht të rëndësishme dhe sfiduese. Shumë kanë propozuar që të gjenden zgjidhje për njohjen e diplomave të universitetit në Mitrovicë. Njohja e dyanshme e diplomave nga Serbia dhe Kosova do të duhej poashtu të ndodhte në një afat të shkurtër. Një folës nga Kosova ka thënë se është e qartë se pjesëmarrësit kanë qëllime të mira për të përmirësuar marrëdhëniet por se “qëllimet e mira nuk mjaftojnë. Ne duhet të jemi më aktiv dhe të fokusohemi në çështjet zhvillimore”.

Deri më tani, dialogu ka dhënë rezultate në lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, si dhe ka lehtësuar bashkëpunimin në fushën e kulturës, mediave, dhe ka mundësuar vizitat e zyrtarëve të lartë të Kosovës në Beograd. Zgjedhjet në veri poashtu janë konsideruar si sukses, por krijimi i komunave është duke u zvarritur.

Një folës ka thënë se parlamentet duhet të krijojnë një mekanizëm për mbikqyrjen e dialogut në Bruksel. Edhe pse një folës ka përkrahur idenë e të pasurit një mekanizëm monitorues të përbashkët mes dy parlamenteve, shumica kanë menduar se një gjë e tillë është e pamundur të bëhet në këtë fazë. Megjithatë, takimet si ky duhet të vazhdojnë dhe të ofrojnë mundësinë për shkëmbimin e informatave. Nevoja që një palë e tretë t’i organizojë dhe ndërmjetësojë këto takime është ende evidente pasi që shkalla e besimit të ndërsjellë ende nuk është në nivel të lartë. Shumica e pjesëmarrësve kanë përkrahur idenë e një takimi tjetër në Beograd në pjesën e parë të vitit 2015. Temat për këtë takim do të ishin personat e zhdukur, dhe shkëmbimi i përvojave në mbikqyrjen e ekzekutivit në të dyja vendet. Disa folës kanë propozuar që ekspertët të ftohen në bazë të temave që do të diskutohen. Ata poashtu janë pajtuar që secili prej tyre të kërkojë nga ekzekutivi përkatës informatat më të fundit në lidhje me situatën e çështjes së personave të zhdukur.

Përfundimi

Pjesëmarrësit kanë konkluduar se bashkëpunimi parlamentar do të kontribuonte jo vetëm në zhvillimin dhe implementimin e politikave, por edhe në përmirësimin e marrëdhënieve të përgjithshme mes serbëve dhe shqiptarëve. Shtendosja e tensioneve mes shoqërive ka rrenjë në takimet joformale të nivelit parlamentar. Përderisa përfaqësuesit e qeverisë zakonisht duhet të rrespektojnë kufizime të caktuara dhe janë në qendër të vëmendjes, parlamentarët mund të flasin më hapur në lidhje me çështjet më të vështira, dhe në këtë mënyrë të shërbejnë si një kanal i rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ata kanë rekomanduar që sa më parë të ketë bashkëpunim në fusha më pak kontraverse, sic janë personat e zhdukur, arsimit, ambientit, shëndetësia, mediat dhe kultura, dhe kanë propozuar që të fillojë bashkëpunimi në fushën e sigurisë, krimit të organizuar, papunësisë dhe zhvillimit ekonomik, nga të cilat do të përfitonin të dyja shoqëritë në mënyrë të barabartë. Ata poashtu kanë thënë se zyrtarët ndërlidhës në Beograd dhe Prishtinë do të mund të ishin më aktiv në lehtësimin e bashkëpunimit në fushat jopolitike. Disa pjesëmarrës kanë thënë se parlamentarët do të mund të kontribuonin poashtu në formimin e Asociacionit.

Një dialog i brendshëm mes qeverisë së Kosovës dhe serbëve të Kosovës, dhe mes dy shoqërive në përgjithësi, është konsideruar thelbësor për krijimin e parakushteve për normalizimin e marrëdhënieve mes serbëve e shqiptarëve në Kosovë. Një ambient i tillë do të ishte me rëndësi të veçantë për të kthyerit.

Qëllimi i projektit të CIG është që bashkëpunimi mes Prishtinës dhe Beogradit të transformohet nga të qenit ngjarje “historike” në ngjarje “të zakonshme”.

Pjesëmarrësit

Aida Corovic, Anëtare e Parlamentit të Serbisë, Partia Demokratike
Illir Deda, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje
Sadri Ferati, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Donika Kada-Bujupi, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Margarita Kadriu, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës
Vladeta Kostic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Progresive Serbe
Alma Lama, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës
Nada Lazic, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lidhja e Social-Demokratëve të Vojvodinës
Petar Miletic, Ish-nënkryetar i Parlamentit të Kosovës
Dardan Molliqaj, Sekretar, Lëvizja Vetëvendosje
Slobodan Petrovic, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lista Srpska
Dejan Radenkovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Janko Veselinovic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Social Demokrate
Vanja Vukic, Anëtar i Parlamentit të Serbisë, Partia Socialiste e Serbisë
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Roinishvili Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Krystyna Marty, Ambasadore e Zvicrrës në Kosovë
Saskia Salzmann, Këshilltare e Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrrës në Kosovë
Talia Wohl, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës